



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes 18.02. 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak të datës 18.02. 2022.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **date 18.02. 2022** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet online.

Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani. Është korumi për fillimin e mbledhjes me 19 anëtarë

Z. Lavdi Hasani :Lexon rendi i ditës dhe kërkesa për mbledhje jashtë radhe.

P/ Vendim “Për një shtesë në buxhetin 2022 për projektin: “Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull”

**Nuk ka pyetje rreth rendit të ditës.Miratohet rendi i ditës me 19 vota pro.**

**Z. Hasani;** Nëse nuk ka pyetje ia kalojmë fjalën ekzekutivit të japë sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë projekt.

Znj. Jorida Muho: Së pari ju falënderoj për mbështetjen që na jepni për të arritur afatet ligjore që nuk varen nga ne por nga donatorët.Në mbledhjen e kaluar u miratua ndryshimi në buxhet dhe iu hap rruga miratimit të marrëveshjes, pas miratimit të marrëveshjes, kërkohet që të miratohet shtesa në buxhet për zbatimin e këtij projekti zhvillimor.

Znj. Rova Flet në emër të Komisionit të Ekonomisë.Komisioni e ka parë materialin dhe është dakord.

Z. Arqile Zhapa: A do të qëndrojë projektin ndërtimi i qendrës multifunksionale ?

Znj. Jorida Muho: Ambientet e tharjes, laboratorit dhe 2 salla muktifunksionale në aspektin edukativ patjetër që do të jenë.

Z. Arqile Zhapa: Po mbas 10 muajve çfarë do të bëhet më tej?

Znj. Jorida Muho;Ky projekt synon rikonstuksionin e godinës, ndërtimin e dy parcelave, ekspertizë, evidentimin e fermerëve, zinxhiri i projektit deri te produkti final.

Z. Arqile Zhapa; A do të ketë vazhdimësi?Kur fillon?

Znj. Jorida Muho; Ky projekt fillon menjëherë pas miratimit.

Z. Vladimir Naçi; Kjo është një punë e mirë e cila do vazhdimësi. Laboratori është pjesë e investimit që i jep vazhdimësi.

Z. Asllan Karagozi; Ky është edhe një motiv për fermerët për punët që i presin.

Z. Hasani; Të shërbejë ky projekt si stimul për fermerët e tjerë.

Z. Hasani; Hedhim në vote: P/ Vendim "Për një shtesë në buxhetin 2022 për projektin: "Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull".

**Miratohet me 19 vota pro.**

Mbyllet mbledhja e Këshillit.

**Sekretar i Këshillit**

**Etleva Yzo**



**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Laydi HASANI**

